

VENDIM
Nr.42, datë 22.4.2011

PËR MIRATIMIN E “METODOLOGJISË SË LLOGARITJES DHE FATURIMIT TË DËMIT EKONOMIK”

Në mbështetje të neneve 9 dhe 51 pika 14 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008 “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 22.4.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e “CEZ shpërndarje” sh.a., për miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes dhe faturimit të dëmit ekonomik”,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes të dëmit ekonomik shkaktuar kompanisë shpërndarëse nga çdo ndërhyrje e paligjshme” (bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë “CEZ shpërndarje” sh.a., për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Entela Shehaj